



Prishtinë, 15 prill 2009  
Kodi i ZRRE-së: V\_174\_2009

**Bordi i Zyrës së rregullatorit për Energji, duke u bazuar në:**

1. Dispozitat e Nenit 22.6, 23 dhe 26 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë të ndryshuar me Ligjin Nr.03/L-080”;
2. Nenin 3 dhe 4.2 të Rregullës “Pasqyrë e taksave”; dhe,
3. Ligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2009,

**në seancën e mbajtur me datë 15 prill 2009, nxori këtë:**

**VENDIM**

- I. **LIROHEN** nga pagesa e taksave vjetore të gjithë të licencuarit në ZRRE, të përcaktuara sipas Pasqyrës së Taksave, për periudhën nga data 01.02.2009 deri me 31.10.2009.

**Arsyetim**

1. Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me qëllim të harmonizimit të Të Hyrave me Buxhetin e Zyrës së Rregullatorit për Energji për vitin 2009, liron të licencuarit për pagesë të taksës vjetore të licencimit sipas Pasqyrës së Taksave si në dispozitiv të këtij vendimi, pasi që:
  - a) Të Hyrat e gjertanishme të mbledhura sipas Nenit 6 dhe 7 të Pasqyrës e taksave plotësojnë Buxhetin e planifikuar të ZRRE-së për vitin 2009.
  - b) Lirimi nga pagesa e taksës vjetore të licencimit për këtë periudhë, për ndërmarrjet që prodhojnë energji elektrike dhe termike do të reflektohet në përcaktimin e të Hyrave të Lejuara për periudhën e ardhshme të shqyrtimit të tarifave (viti 2010), përmes bashkërendimit të të Hyrave të Lejuara.
2. Ky Vendim nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve , do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
3. Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



**Këshillë Juridike:** Kundër këtij Vendimi, pala e pakënaqur mund të paraqesë ankesë në Gjykatën e juridiksionit përkatës brenda 14 ditëve nga data e miratimit ose data e publikimit të vendimit në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Bordi i ZRRE-së**

---

Dr. Ali Hamiti, kryesues

---

Theranda Beqiri, anëtare

---

Dr. Nysret Avdiu, anëtar

---

Përparim Kabashi, anëtar

---

Blerim Koci, anëtar